



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Ministri

Nr. 4021 Prot.

Tiranë, më 2.08.2013

U D H Ë Z I M

Nr. 34, datë 2.8.2013

PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE BUXHETORE DHE NDJEKJEN E PROCEDURAVE  
TË PROKURIMIT PËR BLERJEN E LIBRAVE TË BIBLIOTEKAVE TË  
INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të" i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Bordi i Rekomandimit të Literaturës Artistike e Lëndëve Shoqërore dhe Bordi i Rekomandimit të Literaturës Shkencore e Didaktike, në përshtatje me kurrikulën e niveleve arsimore, përzgjedhin literaturën:
  - a) nga literatura përkatëse e mëparshme;
  - b) nga ofertat e shtëpive botuese, pas shpalljes së kërkesës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
2. Bordet i paraqesin për miratim ministrit të Arsimit dhe Shkencës dy listat e literaturës së parashikuar në pikën 1, shoqëruar me shpjegimet e përzgjedhjes.
3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i dërgon çdo drejtorie arsimore rajonale (DAR)/zyre arsimore (ZA):